



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:243141

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647633

KPPP.nr. 1852/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ORBICO” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70213697 dhe me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë – Shkup, Llapnaselo, kundër debitorit “Toifor” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810484890 dhe me seli në Prishtinë, Lagjia Emshir, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1765/2023 i datës 07.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Toifor” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1765/2023 i datës 07.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “ORBICO” Sh.P.K., me datë 07.10.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 1765/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. FSHP21-15405, e datës 03.12.2021; Faturës nr. FSHP22-00104, e datës 10.01.2022; Faturës nr. FSHP22-00506, e datës 17.01.2022; Faturës nr. FSHP22-01102, e datës 27.01.2022; Faturës nr. FSHP22-00856, e datës 24.01.2022; Faturës nr. FSHP22-02823, e datës 25.02.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,498.74 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbartimor me arsyetim se kreditori ka iniciuar procedurën përmbartimore në bazë të dokumenteve të besueshme, faturave të specifikuara në propozimin për përmbartim, duke mos u bazuar në ndonjë marrëveshje apo kontratë e cila paraqitet si punë e vlefshme juridike, mbi bazën e së cilave do të lëshoheshin faturat. Ka shtuar se fatura nr. FSHP21-15405, e datës 03.12.2021 nuk është pranuar nga debitori, pasi që e njëjta është e vulosur vetëm nga kreditori, por jo edhe nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se përmbartimi është lejuar duke u bazuar në dokumentet e besueshme, të cilat përmbajnë të gjitha elementet sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së. Ka shtuar se debitori sipas porosisë së tij është furnizuar me mall nga kreditori dhe për sasinë e mallit ka lëshuar fatura, të cilat janë pranuar nga zyrtarët e autorizuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. FSHP21-15405, e datës 03.12.2021; Fatura nr. FSHP22-00104, e datës 10.01.2022; Fatura nr. FSHP22-00506, e datës 17.01.2022; Fatura nr. FSHP22-01102, e datës 27.01.2022; Fatura nr. FSHP22-00856, e datës 24.01.2022; Fatura nr. FSHP22-02823, e datës 25.02.2022, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i

përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Në anën tjetër, debitori nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së për mbështetje të prapësimit, andaj në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1852/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.